

OBSERVATORI I EKONOMIVE TË PALIGJSHME NË EVROPËN JUGLINDORE

NUMRI **21** MAJ
2025

Përmbledhje e pikave kryesore



Kriminelët ballkanas të përfshirë në shkallë të madhe në kontrabandë përmes Hamburgut.

Grupet kriminale nga Ballkani Perëndimor janë shfaqur si aktërë kryesorë në trafikun e kokainës përmes Portit të Hamburgut — i cili është qendra e tretë më e madhe e kontejnerëve në Evropë. Si rrjetet shqipfolëse ashtu edhe grupet sllavofolëse tani po i koordinojnë operacionet e sofistikuara të kontrabandës nga Amerika e Jugut, me sisteme të krijuara mirë për nxjerrjen e kokainës nga kontejnerët dhe shpërndarjen e saj në të gjithë Evropën. Pavarësisht sekuestreimeve rekorde, këto rrjete kriminale demonstrojnë qëndrueshmëri dhe përshtatshmëri të jashtëzakonshme. Edhe pse autoritetet gjermane kanë bërë përpertime në rritjen e sigurisë në port, mbeten boshllëqe të konsiderueshme në përballjen me korrupsionin dhe në zhvillimin e koordinimit efektiv me agjencitë e zbatimit të ligjit në Ballkan.



Shpresat e mëdha: Rrugëtimi i Shqipërisë drejt kanabisit mjekësor.

Shqipëria është duke punuar drejt legalizimit të kultivimit të kanabisit mjekësor përmes krijimit të kornizave rregullatore dhe pjesëmarrjes në organe ndërkombëtare. Pavarësisht historisë së trazuar të vendit me prodhimin e paligjshëm të kanabisit, qeveria ka krijuar Agjencinë Kombëtare për Kontrollin e Kanabisit dhe ka zbatuar masa të rrepta sigurie për kultivimin e ligjshëm. Megjithatë, shqetësimet mbeten duke u bazuar në përvojën e Maqedonisë së Veriut, ku kanabisi i kultivuar ligjërisht po devijohet në tregun e zi dhe ku procedurat e licencimit janë përballur me akuza për korrupsion. Procesi i licencimit në Shqipëri përfshin tarifa dhe verifikime të konsiderueshme të të dhënave, por mbeten pikëpyetje në lidhje me rreziqet e korrupsionit si dhe në sigurimin e përdorimit të duhur të ardhurave tatimore nga industria.



**GLOBAL
INITIATIVE**
AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME


Kriminelët ballkanas të përfshirë në shkallë të madhe në kontrabandë përmes Hamburgut.

Hamburgu, një qytet portual kryesor që gjendet në Gjermaninë veriore, shërben si një pikë hyrëse kyçe për kokainën e trafikuar nga Amerika Latine në Evropë për shkak të vendndodhjes së tij strategjiko-geografike dhe vëllimit të lartë të qarkullimit të kontejnerëve. Një pjesë e qarkullimit të kokainës përmes portit drejtohet nga rrjetet kriminale nga Ballkani. Edhe pse autoritetet Gjermane dhe ndërkombëtare po kërkojnë ta trajtojnë problemin, kërkojnë përpjekje të fuqizuara, duke përfshirë investimet në uljen e bashkë-përfshirjes së personelit të portit dhe një koordinim më të madh me autoritetet ligjzbatuese dhe portuale të Ballkanit.

Në vitin 2023, porti i Hamburgut në lumin Elba, i njohur si porta e Gjermanisë drejt botës, trajtoi 7.7 milionë kontejnerë, duke e bërë atë portin e tretë më të madh evropian për nga qarkullimi.¹ Gjatë atij viti, ligjzbatuesit

gjerman sekuestruan një sasi rekord prej 43 tonësh kokainë në të gjithë vendin,² përfshirë gati 34 ton – gati 80% – të kapur vetëm në portin e Hamburgut.³ Numri i hetimeve në proces të krimeve të rënda dhe ndërkombëtare për drogë në qytet u rrit në 111 në vitin 2023, duke shënuar një rritje prej gati 30% krahasuar me vitin 2022 dhe duke vendosur një rekord.⁴

Përderisa rëndësia e Hamburgut në trafikun ndërkombëtar të kokainës është e dokumentuar mirë,⁵ roli i rrjeteve kriminale të Ballkanit mbetet relativisht i paeksploruar. Këto rrjete, të përbëra nga grupe shqiptarë të udhëhequra kryesisht nga shqiptarë të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe grupe sllavofolëse të drejtuara kryesisht nga serbë dhe malazezë, janë shumë të aftë në koordinimin e dërgesave të vazhdueshme të kokainës nga Amerika e Jugut në



Qeveria gjermane raporton se sekuestrimet e kokainës në portin e Hamburgut — shpesh të fshehura në kontejnerë — u trefishuan nga 9.5 ton në vitin 2019 në 33.9 ton në vitin 2023.

Fotografia: Andreas Rentz nga Getty Images

Evropë, duke u mbështetur si në portin e Hamburgut ashtu edhe në vetë qytetin.

Për shembull, në dhjetor të vitit 2024, policia e Malit të Zi arrestoi tre malazezë të akuzuar për trafikimin e 509 kilogramëve kokainë në bordin e anijes shtetërore malazeze të mallrave *Budva*, duke ringjallur një rast të profilit të lartë që daton gati pesë vjet më parë.⁶ Raportohet se kokaina ishte ngarkuar në portin Santos në Brazil, e fshehur në mesin e sheqerit me sasi të madhe të destinuar për në Kazablanka të Marokut. Edhe pse sheqeri u shkarkua në Kazablanka, kokaina mbeti e fshehur në anije, e cila u sekuestrua nga policia gjermane me mbërritjen e saj në Hamburg në maj të vitit 2020.⁷ Të dyshuarit zgjodhën të heshtnin në mbrojtje të tyre para prokurorisë malazeze.⁸

Një nga të arrestuarit në Mal të Zi në dhjetor 2024, Mladen Radulović, ishte mbajtur në arrest më parë në Hamburg në mes të majit dhe nëntorit 2020 në lidhje me të njëjtin rast. Megjithatë, ai më pas ishte liruar nga paraburgimi gjerman për shkak të paraburgimit të padrejtë, sipas ekipit të tij ligjor.⁹

Në nëntor të vitit 2024, autoritetet shqiptare ekstraduan Princ Doboshin – një shqiptar nga Kosova i akuzuar për kryerjen e operacioneve të mëdha të kontrabandës së kokainës përmes portit të Hamburgut – në Gjermani pasi e arrestuan atë në Tiranë.¹⁰ Prokurorët e Hamburgut e kanë akuzuar atë për përfshirje në 11 raste të kontrabandës që përfshijnë një total prej rreth 10 tonësh kokainë, sipas Die Zeit.¹¹ Doboshi është vënë gjithashtu në shënjestër të Prokurorisë Speciale kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) të Shqipërisë, e cila sekuestroi disa nga pasuritë e tij në mars 2024 me arsyetimin se ato ishin financuar nga trafiku i kokainës.¹² E kaluara e tij kriminale daton që nga vitet e 90-ta.¹³

Në shtator të vitit 2024, policia e Hamburgut sekuestroi më shumë se 2 ton kokainë të fshehur në kuti bananesh brenda një kontejneri transporti pranë portit.¹⁴ Operacioni çoi në arrestimin e 12 të dyshuarve, të moshës në mes 21 dhe 43 vjeç, nga Gjermania, Turqia, Afganistani, Iraku, Siria, Shqipëria dhe India. Disa nga të arrestuarit ishin tashmë të njohur për ligjzbatuesit për krime të lidhura me drogën.¹⁵ Ky sekuestrim zbuloi një operacion të mundshëm bashkëfinancimi, të projektuar



Policia gjermane paraqet 2 ton kokainë të sekuestruar në portin e Hamburgut në shtator 2024.

Fotografia: Picture Alliance nga Getty Images

për të lejuar grupe të shumta të ndajnë të ardhurat pas mbërritjes së kokainës në portet evropiane, sipas një studiuesi të specializuar në gjurmimin e organizatave kriminale shqiptare.¹⁶ Grupet shqiptare janë të përfshira në mënyrë aktive në marrëveshje të tilla, duke demonstruar natyrën bashkëpunuese dhe ndërkombëtare të operacioneve të trafikimit të drogës.¹⁷

Statistikat e ligjzatuesve konfirmojnë praninë e fuqishme të grupeve kriminale të Ballkanit në Gjermani. Në vitet 2022 dhe 2023, shtetasit shqiptarë dhe serbë ishin ndër pesë kombësitë kryesore të dyshuara për përfshirje në krimin e organizuar në Gjermani, sipas Zyrës Federale të Policisë Kriminale.¹⁸ Numri i të dyshuarve serbë pothuajse u trefishua në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, duke u rritur nga 165 në 450, derisa numri i të dyshuarve shqiptarë u rrit nga 254 në 285.¹⁹

Ligjzatuesit, raportet e mediave dhe burimet e shoqërisë civile në Hamburg tregojnë se grupet shqipfolëse perceptohen si më të dukshme në qytetin dhe portin e Hamburgut sesa grupet sllavofolëse. Kjo dukshmëri e rritur ka të gjasë të lidhet me praninë e tyre më të gjatë në qytet. Megjithatë, kjo nuk tregon domosdoshmërisht se rrjetet kriminale ballkanike kanë një prani më të fuqishme në Hamburg sesa akterët e tjerë kriminale kombëtarë ose ndërkombëtarë. Dukshmëria e tyre më e lartë mund të rrjedhë nga përfshirja e tyre aktive në nivelin operativ, gjë që i bën ata më të ekspozuar ndaj përpjekjeve të ligjzatuesve, sipas një studiuesi që ndjek nga afër krimin e organizuar evropian.²⁰

Grupet shqipfolëse

Sipas një gazetari hulumtues vendas me përvojë, rrjetet kriminale shqiptare kanë qenë të pranishme në Hamburg që nga vitet e 80-ta,²¹ veçanërisht në trafikun e drogës dhe shfrytëzimin seksual. Në vitin 2023, autoritetet gjermane iniciuan 38 hetime penale që synonin kryesisht grupet kriminale shqiptare, duke përfshirë 23 raste të përqendruara në trafikimin e kokainës dhe 15 që përfshinin operacione të paligjshme me kanabis.²²

Prania kriminale me etni shqiptare në Hamburg mendohet se ka filluar me klanin Osmani nga Kosova, i cili krijoi një pikëmbështetje në qytet në vitet e 80-ta.²³ Deri në vitet e 90-ta, dolën në pah grupe të tjera kriminale shqiptare, të përqendruara kryesisht në shfrytëzimin seksual, veçanërisht në lagjen e dritave të kuqe në Hamburg. Sipas një gazetari lokal, deri në vitet 2000, pasuria e klanit Osmani vlerësohej në 100 milionë euro, duke përfshirë investime të konsiderueshme në

pasuri të paluajtshme, veçanërisht në lagjen e dritave të kuqe në Hamburg.²⁴

Megjithatë, anëtari i dyshuar i klanit, Bashkim Osmani pretendon se pasuria e tij është ndërtuar thjesht përmes investimeve të ligjshme në Hamburg dhe më vonë në Spanjë. Në një intervistë me gazetën kroate Nacional, të botuar në gusht të vitit 2007, Bashkimi deklaroi se familja e tij kishte ndërtuar pasuri të konsiderueshme në Gjermani, pjesërisht përmes investimeve në pasuri të paluajtshme dhe lidhjeve politike.²⁵ Një gazetar hulumtues lokal pretendoi se lidhjet politike të familjes në Hamburg u mundësuan atyre të vepronin për shumë vite nën syrin e ligjzatuesve,²⁶ i cili ka luftuar për dekada të tëra për të ndërtuar një rast të suksesshme kundër klanit Osmani.

Megjithatë, në shkurt të vitit 2022, Bashkim Osmani u arrestua në Kroaci si pjesë e një operacioni të koordinuar nga Europol i që përfshinte bastisje në gjashtë shtete evropiane, në të cilat u arrestuan 45 të dyshuar me dyshimin se i përkisnin një rrjeti kokaine të lidhur me Amerikën e Jugut.²⁷ Informata të rëndësishme mbi operacionet e dyshuara të grupit në Hamburg dhe më gjerë dyshohet se u siguruan nga dekodimi i Encrochat, një platformë mesazhesh të koduara të përdorur nga kriminelët.²⁸

Të dyshuarit, kryesisht shqipfolës, akuzohen për kontrabandën e toneve të kokainës në Evropë përmes porteve kryesore. Bashkim Osmani u transferua në Majorka dhe u vu në paraburgim, i akuzuar të jetë anëtarë i një organizate kriminale dhe për pastrim parash.²⁹ Megjithatë, gazeta Majorca Daily Bulletin raportoi në qershor të vitit 2022 se ai ishte liruar pasi kishte paguar një garanci prej 400 000 euro; avokati i tij pohoi në gjykatë se nuk kishte "asnjë provë" kundër tij.³⁰

Një ekspert i drogës nga Hamburgu shpjegoi se kriminelët shqiptarë janë lojtarë kyç në tregtinë e shumicë të kokainës, së bashku me grupet turke dhe kurde. "Shqiptarët janë përgjegjës për nxjerrjen e kokainës nga porti", theksoi ky ekspert.³¹ Në tetor të vitit 2023, policia gjermane arrestoi tre shtetas shqiptarë në Hamburg me dyshimin për përfshirje në trafikim të kokainës në shkallë të madhe.³² Sipas doganës së Hamburgut dhe prokurorëve lokal, të dyshuarit punonin në port dhe kishin qasje në kontejnerë. Gjatë operacionit, policia konfiskoi gati 240 kilogramë kokainë të fshehur në një kontejner me origjinë nga Amerika e Jugut.³³

Grupet sllavofolëse

Ndryshe nga homologët e tyre shqiptarë, grupet kriminale sllavofolëse nuk kanë një prani të gjatë në qytet dhe port. Aktivitetet e tyre në Hamburg u vërejtën për herë të parë në vitet 2010, duke shënuar një zhvillim më të ri në ndikimin e rrjeteve kriminale të Ballkanit.

Një nga rastet më të hershme të zbuluara nga ligjzatuesit që lidh grupet sllave, trafikun e kokainës dhe portin e Hamburgut daton nga viti 2019 dhe përfshin Petar Ćosić, i njohur edhe si Šarac, një shtetas kroat. Ćosić, një ish-oficer i forcave speciale, ka qenë një figurë qendrore në tregtinë e drogës në Ballkan dhe një bashkëpunëtor i besuar i Darko Šarić.³⁴ “Lidhja e tyre raportohet se daton që nga shërbimi i tyre ushtarak së bashku në vitin 1989, duke e theksuar një partneritet të ndërtuar mbi dekada të besimit”, shpjegoi një reporter krimi me përvojë nga Kroacia.³⁵

Šarić, nga Mali i Zi, i cili ka edhe një pasaportë serbe, drejtonte një rrjet të gjerë kontrabande kokaine nga Amerika e Jugut në Evropë. Në nëntor të vitit 2020, një gjykatë apeli serbe konfirmoi një dënim me burg prej 15 vitesh të dhënë ndaj Šarić, dy vjet më parë për rolin e tij në trafikimin e 5.7 ton kokainë në vitet 2008 dhe 2009.³⁶ Ćosić menaxhoi logjistikën dhe mbikëqyrë shpërndarjen e drogës për Šarić, veçanërisht në Kroaci. Në vitin 2011, Ćosić u arrestua gjatë operacionit Dogma për kontrabandën e të paktën 368 kilogramëve kokainë,³⁷ dhe rrjedhimisht u dënua me katër vite burg.³⁸ Kroacia, Mali i Zi dhe Serbia ishin në qendër të operacioneve të tyre, duke shërbyer si qendra kritike për transportimin e kokainës në Evropë dhe pastrimin e parave. Bashkëpunimi i tyre vë në pah shfrytëzimin strategjik të dobësive rajonale nga rrjetet kriminale të Ballkanit.

Lidhja në mes të Ćosić-it dhe portit të Hamburgut mund të gjurmohet që nga dhjetori i vitit 2019. Prokurorët kroatë pretenduan në prill 2023 se Ćosić kishte mbikëqyrur një dërgesë prej një ton kokainë, duke e transportuar drogën nga Kolumbia përmes Ekuadorit në Evropë.³⁹ Në portin e Guayaquil në Ekuador, 500 kilogramë kokainë u fshehën në një kontejner transporti në bordin e MSC Zlata R dhe u transportuan në Evropë përmes Antwerpit dhe Hamburgut.

Përpjekjet për të nxjerrë këtë kokainë në Antwerp nuk patën sukses, duke i shtyrë trafikantët ta transferonin kontejnerin në anijen Joanna për ta lëvizur më tej në Hamburg. Me mbërritjen e kokainës në Hamburg, kriminelët arritën të kenë qasje në kontejner pasi ai doli

nga porti dhe e nxorën me sukses kokainën. Nga 500 kilogramët, 350 u shitën për rreth 28 000 euro për kilogram. 150 kilogramët e mbetur thuhet se u mbajtën si pagesë në natyrë, si kompensim nga stafi operativ që nxorën ngarkesën në portin e Hamburgut.⁴⁰

Një tjetër lojtar kyç i dyshuar në anën sllave të rrjeteve kriminale të Ballkanit është karteli Tito dhe Dino, i udhëhequr nga Edin Gačanin, një shtetas i Bosnjës dhe Hercegovinës i cili mban një pasaportë holandeze.⁴¹ Prokurorët holandezë dyshojnë se ky kartel ka mundësuar kontrabandën në vitin 2020 të rreth 1.8 ton kokainë përmes portit të Hamburgut, me destinacion përfundimtar Holandën.⁴² Qeveria amerikane e ka identifikuar Gačanin si një nga top trafikantët e drogës në botë.⁴³ Grupi i tij mbajti aleanca të forta me organizata të tjera të mëdha kriminale, përfshirë grupin Kinahan nga Irlanda dhe “Macro” mafian holandezo-marokene,⁴⁴ duke forcuar ndikimin e saj në të gjithë Evropën dhe më gjerë.

Hamburgu është vënë në dukje gjithashtu në një rast të lidhur me Malin e Zi si një pikë hyrëse e kushtueshme për dërgesat e kokainës nga Amerika e Jugut në Evropë. Komunikimet e koduara të përgjuara në platformën Sky ECC supozohet se zbuluan se Radoje Zvicer, udhëheqësi i dyshuar i klanit Kavač – një nga organizatat kriminale më të fuqishme të Malit të Zi – diskutoi lidhjet e tij në Hamburg si një mundësi për nxjerrjen e kokainës nga porti. Megjithatë, thuhet se Zvicer shprehu shqetësime në lidhje me koston e lartë, duke deklaruar se bashkëpunëtorët në Hamburg kërkuar 25% të vlerës totale të ngarkesës së kokainës, të cilën ai supozohet se e konsideroi të tepërt.⁴⁵

Nuk ka dyshim se porti i Hamburgut është një qendër kritike për trafikimin e kokainës në Evropë, duke tërhequr një gamë të gjerë rrjetesh kriminale për shkak të vendndodhjes së tij strategjike dhe marzheve të larta të fitimit. Derisa grupet kriminale të Ballkanit janë thellësisht të përfshira në port dhe qytet, ato nuk njihen për metodat e dhunshme në Hamburg,⁴⁶ sipas ligjzatuesve në Hamburg. Në vend të kësaj, ata përqendrohen drejtpërdrejt në logjistikë të sofistikuar dhe partneritete strategjike për të lehtësuar kontrabandën dhe shpërndarjen e drogës. “Aktualisht, organizatat kriminale aktive në Hamburg janë më shumëkombëshe”, shpjegoi një operator i ligjzbatimit në lumin Elba.⁴⁷

Njohja e problemeve

Autoritetet në Hamburg në janar të vitit 2024 iu bashkuan Aleancës Evropiane të Porteve, një iniciativë për rritjen e sigurisë në të gjitha portet e BE-së.⁴⁸ Aleanca përqendrohet në përmirësimin e efikasitetit doganor në skanimin e kontejnerëve dhe inspektimin e importeve, së bashku me operacione të synuara të ligjzbatimit në porte. Gjithashtu nxit bashkëpunimin, duke promovuar partneritete publiko-private për të mbështetur autoritetet e portit dhe kompanitë e transportit detar, së bashku me mbrojtjen e logjistikës, informatave, personelit dhe proceseve operative.⁴⁹

Në maj të vitit 2024, autoritetet e Hamburgut hapën Qendrën e Sigurisë së Portit për të rritur mbikëqyrjen dhe për të luftuar krimin e organizuar brenda portit.⁵⁰ I krijuar me bashkëpunimin e policisë, doganave dhe prokurorëve, ai lehtëson shkëmbimin e informatave dhe identifikon modelet e aktiviteteve të dyshimta në një fazë të hershme. Një portal për sinjalizuesit është zhvilluar për të mbështetur këto përpjekje, duke u mundësuar punonjësve të portit të raportojnë aktivitetet të dyshimta në mënyrë anonime. Për më tepër, autoritetet zhvilluan një fushatë ndërgjegjësimi publik për të edukuar punonjësit e portit rreth rreziqeve të rekrutimit kriminal.⁵¹

Gjithashtu në maj të vitit 2024, Hamburgu organizoi një takim ministror të Koalicionit të vendeve Evropiane kundër krimit të organizuar dhe të rëndë, duke bashkuar ministrat nga Gjermania, Belgjika, Holanda dhe Franca, si dhe përfaqësues nga Amerika Latine. Suedia iu bashkua koalicionit si anëtare e re.

Një rezultat kyç i takimit ishte miratimi i Deklaratës së Hamburgut, një strategji tre-drejtimit që synon të ndërpresë furnizimet me kokainë në rrjedhën e sipërme ose afër burimit në Amerikën e Jugut; të rrisë bashkëpunimin në mes të doganave, ligjzbatuesve dhe operatorëve të sektorit privat aktivë në portet evropiane dhe përgjegjës për to; si dhe të përmirësojë bashkëpunimin ndërkufitar nga ligjzbatuesve për të ndërprerë dhe shpartalluar operacionet financiare të rrjeteve kriminale.⁵²

Autoritetet gjermane vunë re një rënie të sekuestrimeve të kokainës në portin e Hamburgut në gjysmën e parë të vitit 2024.⁵³ Përderisa kjo mund të tregojë një ulje të

fluksit të kokainës në Hamburg, mund edhe të pasqyrojë gjithashtu se organizatat e trafikimit të drogës po përdorin metoda më të sofistikuara të fshehjes në përgjigje të masave të shtuara të sigurisë. Pavarësisht këtyre ndryshimeve, disponueshmëria dhe çmimi i kokainës, përfshirë edhe në Hamburg, kanë mbetur të qëndrueshme,⁵⁴ duke sugjeruar qëndrueshmërinë e vazhdueshme të rrjeteve të trafikimit.

Boshllëqe të vazhdueshme në politika

Masa me synime më të qarta janë thelbësore për të luftuar në mënyrë efektive infiltrimin e grupeve kriminale të Ballkanit, në veçanti në trajtimin e rreziqeve të korrupsionit dhe forcimin e sigurisë së porteve evropiane. Dobësitë e punonjësve të portit ndaj rekrutimit kriminal mbeten jo mjaftueshëm të trajtuara, pasi që përpjekjet aktuale janë të kufizuara në udhëzime të përgjithshme dhe jo në strategji të zbatueshme. Këto masa mund të përfshijnë krijimin e një partneriteti me Rrjetin Detar Kundër Korrupsionit,⁵⁵ një iniciativë e udhëhequr nga industria, e shpërblyer me çmim, që përfaqëson më shumë se 50% të tonazhit global të transportit detar dhe bashkëpunon me qeveritë dhe shoqërinë civile.

Përderisa nevoja për të gjurmuar dhe konfiskuar pasuritë virtuale të blera me fitime kriminale njihet në deklaratën e Hamburgut, nuk ka përgjigje taktike të mjaftueshme për të kundërshtuar lëvizshmërinë dhe përshtatshmërinë e rrjeteve kriminale, duke përfshirë ato nga Ballkani, të cilat shpesh shfrytëzojnë pikat e dobëta të ligjzbatuesve.

Vëmendje më e madhe nevojitet gjithashtu për rolin e ndërmjetësve, siç janë grupet ballkanike që menaxhojnë logjistikën në Evropë dhe lidhjen e tyre me vendet e origjinës. Bashkëpunimi në mes të autoriteteve ligjzbatuese dhe portuale të Evropës Perëndimore dhe Ballkanit për të kapur drogën përpara se të mbërrijë në portet evropiane është i pazhvilluar dhe kërkon përmirësim të ndjeshëm. Për shembull, asnjë nga portet në Ballkan nuk është pjesë e Aleancës Evropiane të Porteve, duke lënë një boshllëk në koordinimin e përpjekjeve. Kjo është e rëndësishme pasi që rruga detare ballkanike sjell kokainë nga Amerika Latine dhe heroinë nëpërmes Turqisë dhe Lindjes së Mesme në Ballkan përmes porteve kryesore tregtare në detet Adriatik, Egje, të Zi dhe Jon.⁵⁶

Shënime

- 1 Porti i Hamburgut, Statistikat: Trajtimi i ngarkesave.
- 2 Ministria Federale e Punëve të Brendshme (Gjermani), *Zusammen wirksam Drogenkriminalität bekämpfen*, 7 maj 2024.
- 3 Zyra Federale e Policisë Kriminale (Gjermani), *Bundeslagebild Rauschgiftkriminalität 2023*, 26 qershor 2024.
- 4 Policia e Hamburgut, *Polizeiliche Kriminalstatistik 2023*, 8 shkurt 2024.
- 5 Për më shumë detaje, shih Daneil Sager/Deutsche Welle, Kokaina për Gjermani, YouTube, 23 nëntor 2023.
- 6 Radmila Grbić, *Kod tužioca ćutali o švercu pola tone kokaina, pa vraćeni u policiju*, Libertas, 10 dhjetor 2024.
- 7 Siniša Luković dhe Jelena Jovanović, *Uhapšen Baranin: Pola tone kokaina zaplijenjeno na brodu Budva u Njemačkoj*, Vijesti, 2 maj 2020.
- 8 Radmila Grbić, *Kod tužioca ćutali o švercu pola tone kokaina, pa vraćeni u policiju*, Libertas, 10 dhjetor 2024.
- 9 Siniša Luković dhe Jelena Jovanović, *Radulović pušten iz pritvora u Njemačkoj*, Vijesti, 2 nëntor 2020.
- 10 *Mutmaßlicher Drogenboss nach Hamburg ausgeliefert*, Norddeutscher Rundfunk, 15 nëntor 2024.
- 11 Frank Drieschner, *'Der Hai': Berühmter Drogenboss nach Hamburg ausgeliefert*, Die Zeit, 14 nëntor 2024.
- 12 Transporti i drogës drejt Gjermanisë – sekuestrohen në Tiranë pasuritë e Princ Dobroshtit dhe Olsi Syziut, Insajderi, 29 mars 2024; SPAK, Komunikatë për shtyp, 29 mars 2024.
- 13 Në vitin 1994, Doboshi u dënua në Norvegji për drejtimin e një rrjeti që furnizonte Evropën Perëndimore me heroinë. Për më shumë detaje, shih Oskar Aanmoen, *Atë herë kur Princi i Kurorës Haakon pothuajse u rrëmbye*, Royal Central, 28 dhjetor 2019.
- 14 Gjermani: Policia e Hamburgut sekuestroi 2 ton kokainë me vlerë 100 milionë euro, Deutsche Welle, 27 shtator 2024.
- 15 Po aty.
- 16 Intervistë me Fatjona Mejdini, Drejtoreshë e Observatorit të Evropës Juglindore, GI-TOC, dhjetor 2024, online.
- 17 Po aty.
- 18 Zyra Federale e Policisë Kriminale (Gjermani), *Bundeslagebild Organisierte Kriminalität 2023*, 5 shtator 2024.
- 19 Po aty.
- 20 Intervist me Ruggero Scaturro, GI-TOC analist i lartë, janar 2025, online.
- 21 Intervistë me një gazetar investigativ, Hamburg, tetor 2024.
- 22 Zyra Federale e Policisë Kriminale (Gjermani), *Bundeslagebild Organisierte Kriminalität 2023*, 5 shtator 2024.
- 23 Claas Meyer-Heuer dhe Roman Lehberger, *Jagd auf mutmaßlichen Clan-Paten: Die Akte Osmani*, Der Spiegel, 5 maj 2022; Julia Jüttner, *Osmani-Prozess: Aufmarsch der Nadelstreif-Angeklagten*, Der Spiegel, 4 mars 2008; Insa Gall, *Der Fall Osmani erschüttert Hamburg*, Welt, 18 gusht 2006; intervistë me një gazetar investigativ në Hamburg, Gjermani, tetor 2024.
- 24 Po aty. Zyra Federale e Policisë Kriminale (Gjermani), *Bundeslagebild Organisierte Kriminalität 2023*, 5 shtator 2024.
- 25 *Bashkim Osmani: 'Bogatstvo sada ulažem u Istru'*, Nacional, 28 gusht 2007.
- 26 Intervistë me një gazetar investigativ, Hamburg, Gjermani, tetor 2024.
- 27 Claas Meyer-Heuer dhe Roman Lehberger, *Jagd auf mutmaßlichen Clan-Paten: Die Akte Osmani*, Der Spiegel, 5 maj 2022.
- 28 Intervistë me një gazetar investigativ, Hamburg, Gjermani, tetor 2024.
- 29 André Zand-Vakili, *Kokainschmuggel? Europol verhaftet Bashkim Osmani*, Hamburger Abendblatt, 17 shkurt 2022.
- 30 Andrew Ede, Bosi i dyshuar i mafias lirohet me kusht, *Majorca Daily Bulletin*, 1 qershor 2022.
- 31 Intervistë me një ekspert lokal për drogat, Hamburg, tetor 2024.
- 32 Top Channel Albania, *Arrestohen tre shqiptarë në Hamburg, policia sekuestron 240 kg kokainë*, YouTube, 5 tetor 2023.
- 33 Po aty.
- 34 Intervistë me një gazetar investigativ, Zagreb, Kroaci, dhjetor 2024.
- 35 Po aty.
- 36 *Šariću pravosnažno 15 godina zatvora za šverc kokaina*, RTS, 9 nëntor 2020.
- 37 *Krijumčari 339 kg kokaina na slobodi: U spektakularnoj akciji ulovili ih s drogom iz Brazila, sudili im godinama, a oni se na kraju nagodili s Uskokom*, Jutarnji List, 5 prill 2017.
- 38 Željko Petrušić, *Otkriveni detalji akcije DOGMA: Kako je razbijena balkanska narko hobotnica i njen hrvatski krak*, Jutarnji List, 24 maj 2011.
- 39 Zyra për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (Kroaci), *Optužnica protiv Petra Čosića i ostalih*, KO-US-19/2023, 12 prill 2023.
- 40 Po aty.
- 41 Forcat evropiane të ligjzatimit sekuestruan mbi 30 ton kokainë të lidhur me operacionet e kartelit Tito dhe Dino, aktivitetet e të cilit shtrihen edhe në pastrim parash dhe lidhje të dyshuara me figura politike në Bosnje dhe Hercegovinë. Për më shumë detaje, shih Azem Kurtic, *Fuçitë e kaltra, bartësit e papërkushtueshëm nga uji: Nga një refugjat boshnjak në bos ndërkombëtar të drogës*, Balkan Insight, 29 maj 2024.
- 42 Zdravko Ljubas, Ligjzbatuesit nga BE-ja së bashku me ato të Emirateve të Bashkuara Arabe godasin klanin Tito dhe Dino, Projekti i Raportimit të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, 29 nëntor 2022.
- 43 Departamenti Amerikan i Thesarit, Thesari synon akterët në Bosnjë dhe Hercegovinë që minojnë stabilitetin dhe nxisin korrupsionin, 15 mars 2023.
- 44 Po aty; Daniel Brombacher dhe Sarah Fares, *Dhuna pa kufij: Pse dhuna e lidhur me drogën po përhapet në Gjermani?*, GI-TOC, 2 shtator 2024.
- 45 Zyra Speciale e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Malit të Zi, *Optužnica protiv Radoje Zvicera i ostalih*, Kt-S. 172/22, 30 dhjetor 2023.
- 46 Europol, Dekodimi i rrjeteve kriminale më kërcënuese të BE-së, 11 tetor 2024.
- 47 Intervistë me përfaqësues të ligjzatimit, Hamburg, tetor 2024.
- 48 Porti i Hamburgut, Aleanca ndërkombëtare kundër kimit të lidhur me drogën, 31 janar 2024.
- 49 Komisioni Evropian, Aleanca Evropiane e Porteve për luftimin e trafikimit të drogës dhe kimit të organizuar, 24 janar 2024.
- 50 Porti i Hamburgut, *Kampf gegen internationale Drogenkriminalität: Hafensicherheitszentrum offiziell eröffnet*, 31 maj 2024.
- 51 Po aty.
- 52 Ministria Federale e Brendshme dhe Komunitetit (Gjermani), Deklarata e Hamburgut e Koalicionit të Vendeve Evropiane kundër Krimin të Organizuar dhe të Rëndë, 7 maj 2024.
- 53 GI-TOC, Monitoruesi Evropian i Trendeve të Drogës, Publikimi 1, 9 dhjetor 2024.
- 54 Po aty.
- 55 Për më shumë detaje, shih veb faqen e Rrjeti Detar Kundër Korrupsionit.
- 56 Për më shumë detaje, shih Ruggero Scaturro dhe Walter Kemp, *Vrimat e portit: Eksplorimi i rrugëve detare të Ballkanit*, GI-TOC, korrik 2022.

Shpresat e mëdha: Rrugëtimi i Shqipërisë drejt kanabisit mjekësor.

Shqipëria është në rrugën drejt legalizimit të kultivimit të kanabisit për qëllime mjekësore, me sinjale të hapave të rritjes gradualë, duke përfshirë krijimin e një organi rregullator kombëtar, miratimin e një kornize ligjore dhe anëtarësimin në një organ rregullator ndërkombëtar. Përderisa këto zhvillime janë inkurajuese, qeveria do të bënte mirë të kushtojë vëmendje mësimave nga Maqedonia e Veriut, ku licencat dyshohet se në fund u kanë sjellë dobi personave të ekspozuar politikisht dhe kanabisi i kultivuar ligjërisht është devijuar në tregun e paligjshëm rekreativ. Një kornizë e fuqishme është thelbësore, duke pasur parasysh se grupet kriminale shqiptare historikisht kanë pasur një dorë të rëndësishme në tregtinë e paligjshme të kanabisit.

Historikisht, Shqipëria ka fituar një reputacion të keq si një burim kryesor i kanabisit në Ballkanin Perëndimor. Në të vërtetë, kanabisi ka qenë një treg i konsiderueshëm i paligjshëm në vend, duke gjeneruar një burim fitimprurës

të të ardhurave për grupet kriminale. Autoritetet filluan ta trajtojnë problemin në vitin 2014, kur policia dhe forcat speciale u angazhuan në një betejë të gjatë me armë me mafian lokale në fshatin Lazarat në jug të vendit, që ishte epiqendra e kultivimit të paligjshëm.¹

Pas asaj goditjeje, kultivimi i kanabisit u bë në shkallë më të vogël dhe më i shpërndarë, duke u zhvendosur nga fushat e mëdha në jug të vendit në parcela më të vogla në rajonet malore në veri, si dhe në kultivim në ambiente të mbyllura. Disa kultivues shqiptarë të kanabisit morrën rrugë dhe çuan aftësitë e tyre të paligjshme në Holandë, Spanjë dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Duke marrë parasysh këtë kontekst historik, erdhi si surprizë kur Kryeministri Edi Rama njoftoi në maj të vitit 2020 se qeveria po përgatiste një projektligj që do të legalizonte kultivimin e marihuanës për qëllime mjekësore. Rrjedhimisht, në korrik të vitit 2023,



Një operacion policor në Lazarat në vitin 2014 shënoi efektshëm fillimin e goditjes së Shqipërisë kundër tregtisë së paligjshme të kanabisit.

Fotografia: Ministria e Punëve të Brendshme e Shqipërisë/Agjencia Anadolu/Getty Images

parlamenti miratoi një ligj që përcaktonte një kornizë fillestare për kultivimin e ligjshëm të kanabisit dhe Shqipëria krijoi një Agjenci Kombëtare për Kontrollin e Cannabis-it (AKKC) në vitin 2023.²

Së fundi, në nëntor të vitit 2024, agjencia kombëtare i është bashkuar Shoqatës së Rregullatorëve të Kanabisit (CANNRA), një organizatë jo-partiake dhe jo-fitimprurëse që përfshin agjenci qeveritare të përfshira në rregullimin e kanabisit, kanabinoideve dhe kërpit në më shumë se 45 shtete të SHBA-së, si dhe në Kanada, Holandë dhe Maltë. Shoqata lidh qeveritë që punojnë në zbatimin e politikave të kanabisit dhe kërpit, dhe promovon të mësuarit, bashkëpunimin dhe koordinimin.³

Duke marrë parasysh këtë, qasja graduale është inkurajuese. Rama kishte informuar, duke e bërë të qartë që në fillim se qeveria do të koordinohet ngushtë me këshilltarët e huaj dhe vendas. Ai gjithashtu theksoi rëndësinë e të mësuarit nga përvojat e vendeve të tjera me kanabisin mjekësor.⁴

Kultivimi i ligjshëm i kanabisit synon të tërheqë investime të huaja dhe të diversifikojë ekonominë. Megjithatë, problemet historike të vendit me kultivimin e paligjshëm të kanabisit në lidhje me krimin e organizuar ngrenë shqetësime të qarta në lidhje me mbikëqyrjen dhe zbatimin.⁵

Mësimet nga Maqedonia e Veriut

Një shqetësim i madh është potenciali për devijim të kanabisit të kultivuar ligjërisht në tregun e zi. Ka mësimet për t'u nxjerrë, jo më larg se nga përvoja e Maqedonisë së Veriut, ku kultivimi dhe eksporti i kanabisit mjekësor u miratua në vitin 2016.

Në disa raste të dokumentuara, kanabisi i prodhuar ligjërisht në Maqedoninë e Veriut përfundoi duke u shitur në sasi të konsiderueshme në tregun e paligjshëm.⁶ Autoritetet kanë kryer disa operacione kundër kompanive të licencuara të dyshuara për shkelje të rregulloreve dhe shpërndarje të paligjshme, duke theksuar nevojën për mbikëqyrje të rreptë për të parandaluar keqpërdorimin e kanabisit të prodhuar ligjërisht.⁷

Një rrezik tjetër i madh është ai i korrupsionit në lëshimin e licencave. Ka pretendime se partitë në pushtet në Maqedoninë e Veriut kanë tendencë të favorizojnë bashkëpunëtorët kur japin licenca dhe se procesi i tenderimit tërhoqi biznesmenë të dyshimtë

(domethënë ata me dënime të rënda penale) si brenda ashtu edhe jashtë vendit.⁸

Ka gjithashtu kritika se janë lëshuar shumë licenca; gati 70 kompani kanabisi u regjistruan deri në mars të vitit 2024, pavarësisht një tregu të kufizuar për kanabisin mjekësor në Maqedoninë e Veriut.⁹ Aktualisht nuk ka asnjë qëllim për të kufizuar numrin e licencave të lëshuara.

Hapat fillestarë të Shqipërisë: një fillim i mirë?

Është e qartë se qeveria e Shqipërisë i ka kushtuar vëmendje të konsiderueshme rrezikut të devijimit në të paligjshmen. Kundërshtimi i përpjekjeve të tilla është nën juridiksionin e Agjencisë Kombëtare për Kontrollin e Cannabis-it të lartpërmendur, një subjekt ligjor publik i financuar nga buxheti nën patronatin e ministrisë së shëndetësisë.

Misioni i saj është të mbikëqyrë, kontrollojë dhe inspektojë kultivimin dhe përpunimin e bimës së kanabisit dhe prodhimin e nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale, si dhe të monitorojë zbatimin e ligjit të korrikut 2023.¹⁰ Në prill 2024, qeveria miratoi strukturën e agjencisë, e cila përbëhet nga një drejtor gjeneral, një koordinator dhe katër drejtori.¹¹

Disa akte nënligjore dhe rregullore janë miratuar dhe publikuar nga qeveria shqiptare; të tjera janë në finalizim. Rregulloret përcaktojnë që kultivimi mund të kryhet në tokë bujqësore të mbrojtur, në serra ose tunele plastike, si dhe në ambiente të mbyllura të pajisura me ndriçim artificial.

Nëse kultivimi zhvillohet në zona të hapura, do të jetë e detyrueshme që pjesa e jashtme të mbrohet nga një mur i qëndrueshëm betoni të paktën katër metra i lartë dhe 25 centimetra i trashë (dhe mbi të ketë tela me gjemba). Ambientet duhet të monitorohen nga kamera me cilësi të lartë dhe të ruhen 24/7 nga personel i autorizuar sigurie.¹²

Përveç kësaj, do të kërkohet edhe përdorimi i pajisjeve elektronike të sigurisë me teknologji të lartë (siç janë detektorët dhe portat me kontroll), ndërsa sinjali i alarmit duhet të jetë i lidhur me një stacion policie dhe qendrën e komandës.¹³ Subjekti i licencuar duhet gjithashtu t'i japë Agjencisë Kombëtare për Kontrollin e Cannabis-it qasje në kamerat në kompleksin e tyre, për të siguruar monitorim të pavarur.¹⁴

Transporti i kanabisit dhe nënprodukteve duhet të kryhet me automjete të plumbosura që sigurojnë që të mos manipulohet me produktin. Sa herë që një subjekt i licencuar dëshiron të transportojë produkte të ligjshme të kanabisit nga një vend në tjetrin, ai duhet të informojë Regjistrin Kombëtar të Aktiviteteve të Licencuara dhe të Lejuara të Cannabis-it dhe Policinë e Shtetit të paktën pesë ditë më parë. Ndërkohë, ruajtja u besohet kompanive private të sigurisë ose kompanisë shtetërore të sigurisë Illyrian Guard; këtyre kompanive do t'u kërkohej të mbajnë praninë e sigurisë së vazhdueshme 24-orëshe.¹⁵

Procesi i licencimeve pritet të filloj,¹⁶ por pa dyshim që ato do të jenë shumë të kërkuara.

Përderisa industria e kanabisit mjekësor në Maqedoninë e Veriut ka hasur vështirësi për shkak të kërkesës së kufizuar të brendshme dhe barrierave të eksportit, Shqipëria mund të perceptohet ndryshe nga investitorët falë klimës së saj bujqësore, kostove më të ulëta të prodhimit dhe narrativës pro-biznes nga qeveria. Nëse Shqipëria arrin të sigurojë qartësi rregullatore dhe të sigurojë tregjet e eksportit — veçanërisht në vendet e BE-së ku kërkesa është në rritje — industria mund të bëhet shumë fitimprurëse.

Aplikimi për licencë do të kushtojë rreth 1 000 euro. Pas vitit të tretë, mbajtësit e licencave do të paguajnë një tarifë vjetore prej 1.5% të qarkullimit të tyre ndaj qeverisë, por jo më pak se 100 000 euro. Një licencë për prodhimin e kanabisit mjekësor do të lëshohet për një periudhë 15-vjeçare, me mundësi rinovimi në bazë të kërkesës. Sipërfaqja totale e lejuar për kultivimin e kanabisit për qëllime mjekësore nuk mund të kalojë 200 hektarë në të gjithë vendin.¹⁷ Sipas legjislacionit dhe rregulloreve, aplikuesit nuk duhet të jenë nën hetim ose të jenë dënuar për një vepër të rëndë penale, nuk duhet

të jenë përdorues droge, si dhe duhet t'i nënshtrohen verifikimeve shtesë të së kaluarës.¹⁸

Megjithatë, kjo mund të mos jetë e mjaftueshme për të adresuar shqetësimet në lidhje me mundësinë e korrupsionit të procesit të dhënies së licencave. Sa i përket rezistencës ndaj krimit të organizuar, Shqipëria renditet e 84-ta në nivel global në Indeksin Global të Krimit të Organizuar të GI-TOC, poshtë Maqedonisë së Veriut e cila gjendet në vendin e 73-të, duke treguar se integriteti i blerjes së licencave të Shqipërisë mund të jetë edhe më i ekspozuar ndaj shfrytëzimit nga akterët e lidhur politikisht.¹⁹

Të ardhurat e gjeneruara nga lëshimi i licencave do të shkojnë në buxhetin e shtetit, ndërsa të ardhurat nga tarifa vjetore e paguar nga subjektet e licencuara do të shpërndahen 70:30 në mes të buxhetit të shtetit dhe AKKC-së.²⁰

Një sfidë tjetër do të jetë siguri që të ardhurat e taksave të rritura nga kanabisi i ligjshëm nuk shihen vetëm si një burim i vazhdueshëm i parave, por ato të përdoren për të përmirësuar sistemin e kujdesit shëndetësor, veçanërisht në aspektin e trajtimit të pacientëve dhe mbështetjes sociale.²¹ Kjo do të kërkojë transparencë të shtuar në menaxhimin e të ardhurave dhe bashkëpunim më të ngushtë në mes të ministrive përkatëse dhe aktorëve të tjerë, siç është shoqëria civile.

Thjeshtë, autoritetet shqiptare duhet të marrin parasysh përvojën e Maqedonisë së Veriut në krijimin e një kornizë rregullatore për kanabisin mjekësor. Ndërkohë që ka prova të qarta se është bërë një kujdes i konsiderueshëm për parandalimin e devijimit të paligjshëm të kanabisit të kultivuar ligjërisht në tregun e zi, ekziston shqetësimi në lidhje me rrezikun e korrupsionit në lëshimin e licencave — dhe mënyrën se si këto rreziqe do të trajtohen siç duhet.

Shënime

- 1 Shih Ruggero Scaturro dhe Giorgio Fruscione, Përtej ideologjisë: Ekstremizmi i dhunshëm dhe krimi i organizuar në Ballkanin Perëndimor, GI-TOC, mars 2025, faqe 30–31.
- 2 Projektligji, i titulluar “Për Kontrollin e Kultivimit dhe Përpunimit të Bimës së Cannabis-it dhe Prodhimit të Nënprodukteve të Saj për Qëllime Mjekësore dhe Industriale”, u miratua pas një debati të konsiderueshëm publik dhe parlamentar.
- 3 AKKC, *Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabis-it bëhet anëtare e CANNRA*, nëntor 2024.
- 4 Shqipëria afër legalizimit të marihuanës mjekësore, Exit News, 9 maj 2020.
- 5 *Kanabisi mjekësor/‘S’duhet të jenë përdorues droge’ – Zbardhet udhëzimi për pastërtinë e figurës së pronarëve! Ja kriteret që duhet të plotësojnë*, Panorama, 17 tetor, 2024.
- 6 Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore, biznesi i legalizuar i kanabisit mjekësor në Maqedoninë e Veriut është në rrezik të marrjes së kahut kriminal, Buletini i Rrezikut, Numri 19, GI-TOC, gusht 2024.
- 7 Po aty.
- 8 Intervistë me Janaki Mitrevskin, një avokat me seli në Maqedoninë e Veriut.
- 9 Intervistë me HOPS, një OJQ me seli në Maqedoninë e Veriut.
- 10 AKKC, *Kompetencat e Agjencisë*.
- 11 AKKC, *Miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-IT*, 23 shkurt 2024.
- 12 Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, *Vendime të miratuara në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, datë 22 Janar 2025*, 22 janar 2025.
- 13 Po aty.
- 14 Po aty.
- 15 *Kanabisi mjekësor, Qeveria përcakton kriteret e kultivimit: Parcela, me mure 4 metra të lartë e sinjale alarmi në polici! Serverat e kamerave monitoruese në BE*, Shqiptarja.com, 9 janar 2025.
- 16 AKKC, *deklaratë zyrtare nga një kërkesë e FOIA-s*.
- 17 AKKC, *Licensimi*.
- 18 Shih udhëzimet e detajuara këtu.
- 19 Indeksi Global i Krimit të Organizuar, Kriminaliteti në Shqipëri, GI-TOC, 2023.
- 20 AKKC, *Vendim për procedurën dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it*, 16 tetor 2024.
- 21 Intervistë me HOPS, Maqedonia e Veriut.

Buletinet e Rreziqeve janë publikime periodike nga observatorët tanë rajonalë, në bashkëpunim me rrjete të shoqërisë civile për të paraqitur të dhëna të reja dhe për të kontekstualizuar prirjet e rrjeteve të krimit të organizuar, tregtisë së paligjshme, dhe reagimit të shtetit ndaj tyre. Nëse doni të abonoheni për të marrë numrat e ardhshëm të "Buletinit të rreziqeve", ju lutemi regjistrohuni këtu ose dërgoni email në Vanja.Petrovic@globalinitiative.net.

MBI "INCIATIVËN GLOBALE"

Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar është një rrjet mbarëbotëror, i përbërë nga më shumë se 700 ekspertë të shpërndarë nëpër të gjithë globin. Iniciativa Globale ka krijuar një platformë për nxitjen e një debati më të gjerë dhe promovimin e përjasjeve inovative, për të krijuar një bazë të fortë për hartimin e një strategjie në nivel global kundër krimit të organizuar.

www.globalinitiative.net

Ky publikim u realizua me mbështetjen financiare të Fondit të Mbretërisë së Bashkuar për Konflikt, Stabilitet dhe Siguri. Përgjegjësia mbi përmbajtjen e këtij publikimi bie vetëm mbi GI-TOC, dhe përmbajtja nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Mbretërisë së Bashkuar.



**GLOBAL
INITIATIVE**
AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME